



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

### PROCESVERBAL

**Mbajtur më 30 shtator 2024**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e KKSBS-së: z. Bashkim Bajrami, komandant i Stacionit të Policisë; z. Shefki Selmani, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; z. Xhafer Ademi, kryesues i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues i komunitetit rom; z. Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit-Podujevë; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Ndërsa munguan: z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; znj. Sevdije Mustafa, përfaqësuese e komunitetit egjiptian; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore z. Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit; znj. Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi dhe z. Shemsi Jashari, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it LMT z. Kovacs, z. Asdren Llugolli përkthyes i përfaqësuesit të KFOR-it, znj. Adelinë Stublla Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; z. Alban Zeka Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit; z. Bekim Karaxhija - OSCE; z. Florent Salihu dhe z. Xhavit Fejza - UNMIK.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, materialet për mbledhje konsideroj i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

### Rendi i Ditës

*Rendi i ditës u miratua njëzëri.*

#### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 17 korrik 2024.**

*U miratuan njëzëri*

#### **2. -Informatë e Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**

**-Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë**

**-Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë**

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, fillimisht fjalën ia kalojmë Komandantit të Stacionit të Policisë z. Bashkim Bajrami.

**z. Bashkim Bajrami**, theksoi, sa i përket situatës së përgjithshme të sigurisë në zonën tonë të përgjegjësisë vlerësohet e qetë dhe stabile, pa ndonjë indikacion për përkeqësim të saj. Ka pasur

numër të konsiderueshëm të rasteve të ndryshme të raportuara, por nuk kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes së përgjithshme. Gjatë periudhës kohore korrik – gusht , e deri me 25 shtator, janë raportuar gjithsej **384** raste të ndryshme. Prej tyre, **158** janë aksidente të trafikut. Nga këto aksidente, **26** janë me persona të lënduar, **35** janë mos ndalje në vendin e aksidentit, kurse të tjerat janë aksidente vetëm me dëme materiale. Këto statistika i referohen vetëm Stacionit tonë, sepse kemi pasur edhe aksidente të cilat kanë qenë të trajtuara nga Trafiku Regional në Fushë Kosovë. Numri i këtyre aksidenteve është 80. Në vazhdimësi kemi Planin Operativ „Siguria në komunikacionin rrugor”. Fokusi ynë gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë sigurimi i një ambienti të qetë për të gjithë qytetarët, parandalimi i kryerjes së veprave të ndryshme kriminale, arrestimi i personave që kanë kryer vepra të ndryshme, apo kanë rënë ndesh me ligjin. Për të realizuar detyrat tona të përditshme në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë dhe për të krijuar një ambient të qetë dhe të sigurt për të gjithë, kemi planifikuar dhe organizuar plane të ndryshme operative, kemi bërë kontrollimin e shtëpive dhe të objekteve përcjellëse të personave që kanë qenë të përfshirë në aktivitete kriminale, apo raste të ndryshme të raportuara. Nënvizoi, kemi pasur një bashkëpunim të mirë me Drejtorinë e Inspeksionit, me të cilën kemi bërë plane të ndryshme për të parandaluar veprimtari të ndryshme që kanë qenë në kundërshtim me ligjin. Gjatë punës tonë të përditshme kemi sekuestruar një numër të konsiderueshëm të armëve ilegale që kanë qenë në dispozicion të qytetarëve. Gjatë kësaj periudhe kohore, janë sekuestruar rreth : 4 pushkë automatike AK-47, 2 pushkë gjysmë automatike, 26 pistoleta të ndryshme, 6 pushkë të gjuetisë, 12 thika të ndryshme, 585 fishekë të kalibrave të ndryshëm. Kemi bërë mbi 25 kontrollime të shtëpive dhe të objekteve përcjellëse, si dhe lokaleve të ndryshme. Nga **384** rastet e raportuara gjatë kësaj periudhe kohore, në njësinë e hetimeve kanë shkuar **261** raste. Nga këto raste **135** prej tyre janë dërguar në prokurori me kryerës të njohur dhe të zbuluar, **24** raste kanë shkuar me raporte të veçanta, **28** kanë shkuar me kryerës të panjohur (NN), **9** kanë shkuar në NJHP, **18** raste janë dërguar në zyrën e trafikut , **1** rast ka shkuar në IKP dhe **46** janë ende nën hetime.

Prej muajit shtator kemi filluar ligjëratat në shkolla fillore dhe të mesme, me temat:“ Qarkullimi i sigurt i fëmijëve në rrugë”. Kjo ligjëratë është mbajtur me nxënësit e klasave 1 dhe 2 të shkollave fillore. Janë mbajtur rreth 14 ligjërata në të cilat kanë qenë të përfshirë rreth 445 nxënës të klasave të para dhe të dyta të shkollave fillore. Po ashtu, janë mbajtur dhe ligjërata me nxënësit e shkollave të mesme, me temat : “Posedimi i armëve të zjarrit – rreziku nga armët dhe pasojat ligjore” , “ Posedimi , shitë blerja dhe përdorimi i substancave narkotike”.

Në këto ligjërata kanë qenë të përfshirë rreth 1322 nxënës të shkollave të mesme. Po ashtu, gjatë sezonit veror jemi ballafaquar edhe me një numër të konsiderueshëm të zjarr vënieve. Disa prej tyre janë mbuluar vetëm me shënime zyrtare, kurse janë hapur 12 raste ndaj personave, të cilët kanë ndezur zjarre të qëllimshme, çoftë për djegie të hamullive apo mbeturinave të ndryshme.

Nënvizoi gjatë kësaj periudhe kohore ka pas angazhim edhe në parandalimin e përdorimit të substancave të ndryshme narkotike. Edhe përkundër faktit se kemi mbajtur ligjërata me nxënësit e shkollave të mesme lidhur me pasojat e përdorimit të këtyre substancave, përsëri kemi pasur një numër të rasteve raportuara të përdorimit të tyre. Në këtë periudhë kohore, në gjashtë raste të raportuara, janë konfiskuar rreth **7.56 gram** të substancave të ndryshme dhe janë hapur raste për personat që kanë përdor apo shpërndarë substanca të tilla.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** fjalën ia kalojmë përfaqësuesit të FSK-së.

**z. Nexhip Jaha, përfaqësuesi i FSK-së,** theksoi, sa i përket çështjes së sigurisë në domenin që FSK e siguron nuk ka ndonjë shqetësim. FSK-së prej datë 16-19 të këtij muaji ka pas një aktivitet fushor, ku në bashkëpunim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim kemi bërë një lajmërim për qytetarët se gjatë kësaj periudhe do të ketë prani të automjeteve dhe ka shkuar gjithçka sipas planit. Ne bashkëpunojmë dhe vazhdojmë të bashkëpunojmë me autoritet komunale dhe organet e sigurisë, sigurisht në punët që i përkasin FSK-së.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, e hapim diskutimin lidhur me informatën e paraqitur nga përfaqësuesi i FSK-së, nëse dikush ka për të shtuar diçka.

Po duket që jemi në rregulle sa i përket informatës, megjithatë unë dua të diskutoj një çështje me përfaqësuesit e KFOR-it të cilët i kemi prezentë në këtë mbledhje. Para pak ditësh ka pas një trajnim fushor në rajonin e Llapit nga KFOR me forcat e Serbisë, së paku kështu kam marr informatën nga mjetet e informimit publik, ndërsa unë si Kryetar i Komunës nuk kam pas asnjë informacion që do të ndodhë diçka e tillë dhe mendoj se do të ishte mirë që ju si përfaqësues të KFOR-it ta paraqitni këtë shqetësim tonin, sepse gjithëherë kur ka diçka që zhvillohet brenda kufijve administrativ të Komunës tonë, e në këtë rast edhe brenda kufijve shtetërorë është mirë që të na informoni, së paku të jemi në dijeni se do të ndodhë një aktivitet i tillë. Unë jam në dijeni se kjo çështje është ekskluzivisht në kompetencën e juaj por është mirë që informatat ti kemi nga Ju e jo të marrim informata nga mjetet e informimit. Mendoj që këtë çështje do ta praktikoni në të ardhmen kurdo që keni aktivitete të tilla. Ne sigurisht që nuk kemi kompetenca të përzihemi në çështjen e sigurisë, por do të ishte mirë që ti kemi së paku këto informacione. Nëse keni ndonjë informatë më shumë rreth kësaj çështje do të ishte mirë të na jepni.

**Përfaqësuesi i KFOR-it**, theksoi, faleminderit që ngritët këtë shqetësim dhe do të dëshiroja që pas mbledhjes këtë ta diskutojmë si një çështje më tepër privatisht.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, ne mund ta diskutojmë edhe në këtë takim sepse takimet tona janë të hapura, por kjo shumë më mirë do të ishte ta bëjmë para se me ndodhë në terren aktiviteti, pra të na informoni se do të ndodhë kjo që u diskutua.

Thënë të drejtën nuk u ndjeva mirë kur informatën e mora prej mjeteve të informimit, përkundër kontakteve të rregullta të cilat i kemi përherë, por gjithsesi do të diskutojmë për këtë çështje, sepse do të mund të qëllonin në terren njerëzit tanë apo zjarrfikësit dhe do të krijohej një situatë jo e këndshme atje. E gjithë kjo me qëllim të koordinimit të punëve.

**Përfaqësuesi i KFOR-it**, theksoi, lidhur me këtë ska problem, mund të them disa fjalë, dmth këto patrullime ka vite që bëhen, nuk jam i sigurt por ka që 20 vite që bëhen patrullime të ndryshme së bashku me trupat serbe në këtë rast me njësinë e xhandarmërisë së Serbisë (Policinë kufitare të Serbisë), por gjithashtu këto patrullime mbahen edhe me Policinë Kufitare të Kosovës. Këto aktivitete planifikohen më herët dhe mbahen rregullisht dhe kurdo që mbahen me Policinë e Kosovës do të koordinohemi me komandën e Policisë kufitare në Lluzhan. Pra mund të them se këto patrullime ka kohë që mbahen dhe nuk është diçka e re, kjo është e tëra që mund të them. Gjithashtu për shqetësimet e juaja dhe të qytetarëve këtë do ta procedoj në instanca tjera komanduese të KFOR-it, por edhe njëherë po e theksoj se patrullimet me trupat kufitare policore të Serbisë dhe me Njësitë e Policisë Kufitare të Kosovës bëhen me planifikim dhe në koordinim dhe kjo ka kohë që bëhet, por parapakisht unë do të bisedoj me zinxhirin komandues dhe pastaj do ju informoj lidhur me këtë çështje.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, ju falënderoj për këto sqarime, absolutisht ne nuk e vejmë në dyshim që këto aktivitete i keni të rregullta, me që jam njeriu i parë i kësaj komune është mirë gjithëherë kur ka aktivitete të tilla parapakisht të na tregoni, ne nuk jemi ata që i ndalim apo i nisim këto, këto janë procese dhe punë të juaja, por mirë është të kemi informata, sepse kanë mundur të shqetësohen qytetarët pa qenë në dijeni të këtij aktiviteti, ose unë personalisht dal herë pas herë në Përpellac në kufi dhe kam mundur në atë moment të qëllojë në atë pjesë aty dhe më pastaj të shqetësohem, duke mos qenë në dijeni se çka është duke ndodhur. Prandaj kërkesa është të kemi së paku një informacion, sepse ne nuk jemi ata që i ndalojmë këto gjëra.

**z. Bashkim Bajrami**, theksoi, patrullimet nga forcat e sigurisë duhet të njoftohen parapakisht në momentin kur ka ngritje të helikopterëve, patrullimet i mbajnë në anën tjetër të kufirit ku këto patrullime i kanë të përbashkëta me palën tjetër. Pra këto aktivitete duhet lajmëruar për shkak të mos shqetësimit të banorëve. Ne kemi kërkuar informacion më detaj lidhur me datën e caktuar dhe jemi informuar se ka pas patrullim të përbashkët, mirëpo ai ka qenë i vonë.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, falënderojmë Komandantin për këto informacione shtesë.

**z. Qefser Behrami**, theksoi, ka qenë e vërtetë se helikopteri jo i policisë por i forcave ushtarake të Serbisë ka hyrë në territorin e Kosovës, konkretisht në fshatin Metehi, dhe ka dalë në mes të fshatrave Metehi dhe Kërprimëh. Është e vërtetë se banorët e atyre fshatrave kanë qenë të shqetësuar. Të gjithë jemi në dijeni se te helikopterët e KFOR-it në pjesën e poshtme shkruhet KFOR, ndërsa kjo nuk figuron te helikopterët e ushtrisë së Serbisë dhe ka dallime te forma e helikopterëve të policisë nga ata të forcave ushtarake, kjo është realiteti. Pra shqetësimi ka qenë tej mase, por më në fund gjendja u stabilizua.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, nga diskutimi i parafolësit shihet se ka pas shqetësime nga ky aktivitet ushtarak dhe si duket po rezulton si e arsyeshme që ne së paku t'i kemi këto informacione si institucione lokale, në mënyrë që ta bëjmë një institucion publik për qytetarët tanë. E tha shumë bukur edhe Komandanti i Stacionit Policor që një numër i madh i qytetarëve punojnë tokat e tyre deri në pikën 0 në brezin kufitar dhe është mirë të kenë këto informacione në mënyrë mos krijohet ndonjë keqkuptim, ndërsa hapësira ajrore aq sa jam në dijeni është në kompetenca të KFOR-it dhe besoj se KFOR-i i përcjell këto, sepse futja e tyre (forcave ushtarake serbe) brenda territorit të Kosovës sa unë e kam të qartë është e ndaluar.

**z. Bashkim Bajrami**, theksoi, është i nevojshëm edhe një sqarim, sa herë që kanë patrullime të përbashkëta dy forcat nuk e shkelin brezin kufitar tonin as me mjete ushtarake as në këmbë, kjo nuk mund të ndodh, sepse unë jam në dijeni të kësaj sepse kam punuar gjatë në Policinë Kufitare dhe ekskluzivisht jam marr me atë çështje. Ne kemi marr raportin për ngjarjen në fshatin Metehi dhe figuron se ishte helikopteri i KFOR-it sipas raportimit. Gjatë patrullimeve të përbashkëta të KFOR-it me Policinë Kufitare të Kosovës nuk shkohet në patrullim deri në pikën 0 sepse për këtë KFOR-i me forcat ushtarake serbe kanë marrëveshjen, e mbajnë një distancë për një (1) km, ndërsa kur në patrullime është vetëm Policia Kufitare ajo shkon deri në pikën 0 dhe i trajton të gjitha rastet eventuale.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, nëse nuk ka dikush tjetër për të shtuar rreth kësaj pike kalojmë në pikën e radhës.

### **3. Informatë për sigurinë në shkolla**

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, fillimisht fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Avni Fetahu.

**z. Avni Fetahu**, theksoi, Drejtoria Komonale e Arsimit synon krijimin e një sistemi arsimor të bazuar në cilësi, gjithpërfshirje dhe llogaridhënie, me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës. Në funksion të kësaj, DKA do të sigurojë infrastrukturë shkollore moderne, mjedis të sigurt, të qetë dhe miqësor, kuadër profesional dhe kompetent për një mësimdhënie cilësore, që do të ju mundësojë të gjithë nxënësve zhvillimin maksimal të potencialeve të tyre, në pajtim me aftësitë psikike e fizike të tyre dhe me kërkesat e shoqërisë.

Shikuar në përgjithësi, dhe duke u bazuar në raportet e policisë dhe raportet e drejtorëve të shkollave, si dhe raportet e DKA në lidhje me sigurinë në shkolla, mund të themi se në këtë vit shkollor gjendja e sigurisë në shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë, stabile dhe e sigurt.

Këtë konstatim e përforcon edhe më shumë mbarëvajtja e tërë procesit mësimor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Komunën e Podujevës si dhe raportet e drejtorëve të shkollave.

#### **Mbledhja me drejtorët e shkollave**

Në funksion të sigurimit të një mjedisi të qetë dhe të sigurt në institucionet shkollore, drejtori i DKA mbanë mbledhje të rregullta me të gjithë drejtorët e shkollave, në të cilën mbledhje janë trajtohen temat:

- Siguria në shkolla – masat për parandalimin e dhunës në shkolla;
- Fuqizimi i organeve udhëheqëse dhe profesionale në shkolla;

#### **Fuqizimi dhe funksionalizimi i plotë i organeve qeverisëse – udhëheqëse dhe profesionale të shkollave**

Duke ditur rolin dhe rëndësinë që kanë organet qeverisëse – udhëheqëse dhe profesionale të shkollës në zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në arsim, por edhe në sigurimin e një mjedisi të qetë e të sigurt në shkolla, fokus të veçantë i kemi kushtuar dhe do të vazhdojmë t'i kushtojmë fuqizimit dhe funksionalizimit të plotë të tyre (Drejtorët e shkollave, Aktivitet Profesional, Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli i Nxënësve, Këshilli i Klasëve, Këshilli i Arsimtarëve, Shërbimi Pedagogjik-

Psikologjik), me qëllim që këto organet ushtrojnë funksionin e tyre në ngritjen e cilësisë në arsim dhe në krijimin një mjedisi të qetë dhe të sigurt në shkolla.

Në këto mbledhje është konstatuar gjendja e sigurisë për secilën shkollë, si dhe propozimet dhe rekomandimet që kanë dalë nga ky takim janë përmbledhur në një raport nga secila shkollë dhe janë sjellë në DKA.

Bazuar në këto raporte mund të konstatojmë se gjendja e sigurisë në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë dhe e sigurt.

#### **Zgjerimi i shërbimit psikologjik dhe pedagogjik**

Në Komunën e Podujevës kemi të punësuar 9 psikologë dhe 3 pedagoge dhe 15 asistente për fëmijë me nevoja të veçanta, e që shikuar në raport me numrin e nxënësve në Komunën e Podujevës është i pamjaftueshëm.

#### **Sigurimi i transportit të nxënësve**

Komuna e Podujevës siguron transport të organizuar për të gjithë nxënësit që kanë distancë nga shtëpia në shkollë mbi 4 km., si dhe për fëmijët me nevoja të veçanta, në gjithë territorin e Komunës së Podujevës, që i vijnë në mesimet në klasat për fëmijët me nevojat e veçanta, në shfmu "Kongresi i Manastirit" në Gllamnik.

#### **Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shkollore**

Me qëllim të krijimit të infrastrukturës moderne, mjedisit të sigurt dhe miqësor për nxënës, Komuna e Podujevës, në kuadër të planifikimeve të saj, edhe për këtë vit ka ndarë buxhet për ndërtimin, zgjerimin dhe renovimin e hapësirave shkollore.

#### **Rregullimi i rrethojave të oborreve të shkollave**

Rrethojat e oborreve të shkollave ndikojnë në ngritjen e sigurisë së shkollave, dhe duke marrë parasysh këtë fakt, Komuna e Podujevës ka bërë investime të konsiderueshme në këtë drejtim. Shumica e shkollave kanë rrethojat e tyre, mirëpo ne do të vazhdojmë edhe këtë vit të ndërtojmë rrethojat edhe në ato shkolla ku rrethoja është e dëmtuar apo nuk kanë fare.

#### **Ndërtimi dhe rregullimi i trotuareve për këmbësor**

Janë ndërtuar shumë trotuare qoftë në zona urbane, por edhe të atyre rurale, të cilat kanë ndikuar në sigurinë e këmbësorëve në përgjithësi, e sidomos sigurinë e nxënësve. Trotuaret e ndërtuara për skaj rrugëve që çojnë për në shkolla, ju mundësojnë qytetarëve, e sidomos nxënësve lëvizje shumë më të sigurt, andaj kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që gjatë planifikimeve për ndërtimin e trotuareve të vazhdojë t'u jep përparësi rrugëve që shpijnë për në shkolla.

#### **Bashkëpunimi i DKA-së me Policinë e Kosovës**

Drejtoria e Arsimit, për sigurimin dhe garantimin e një mjedisi të qetë dhe të sigurt në shkollë bashkëpunon ngushtë me Policinë e Kosovës. Në të gjitha organizimet dhe aktivitete që kemi realizuar, e që e kemi vlerësuar të nevojshme të jenë policia, e kemi pasur mbështetjen e tyre. Gjithashtu kemi zhvilluar edhe takime të drejtpërdrejta qoftë me Komandantin e Stacionit të Policisë së Podujevës, qoftë me zyrtarët tjerë, ku i kemi bashkërenduar veprimet dhe aktivitetet e ndryshme, me qëllim që të jemi më efikas në kryerjen e punëve, detyrave dhe përgjegjësi tona.

Prezenca e policisë në afërsi të shkollave në qytet, sidomos në shkollat e mesme të larta është e nevojshme.

Presim që ky bashkëpunim në mes DKA dhe Policisë të vazhdojë edhe më tutje, në mënyrë që të sigurojmë një mjedis të qetë dhe të sigurt për të gjithë komunitetin shkollos.

#### **Instalimi i kamerave të sigurisë**

Nga takimet e rregullta që kemi zhvilluar me drejtorët e shkollave, si dhe nga takimet që i kanë zhvilluar Këshillat Drejtues të Shkollave në Komunën e Podujevës, por edhe me palë tjera të interesit, është identifikuar nevoja që në shkolla të instalohen kamerat e sigurisë.

Tani më veç kanë filluar të zhvillohen procedurat tenderuese për këtë projekt. Shkollat që do të përfitojnë nga ky projekt janë: Gjimnazi "Aleksandër Xhuvani" Podujevë, SHMLT "Fan S. Noli" Podujevë, SHFMU "Enver Maloku" Podujevë, SHFMU "Xheladin Rekaliu" Podujevë, SHFMU "Dituria" Llapashticë e Poshtme, SHFMU "Kongresi i Manastirit" Gllamnik, SHFMU "Afrimi e Fahriu" Lluzhan, SHFMU "Zenel Hajdini" Lupç i Poshtëm, SHFMU "Ali Ajeti" Sfeqël, SHFMU "Naim Frashëri" Podujevë, SHFMU "Pavarësia" Sibovc, SHFMU "Hyzriu e Samiu" Letanc, SHFMU "Sheqë Mirovci" Shtedim (16 shkolla).

#### **Sfidat**

Përkundër vlerësimeve të gjendjes së sigurisë së përgjithshme në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Podujevës si të qetë, të sigurt dhe stabile, megjithatë kemi çështje, fatmirësisht jo të shumta,

të cilave ende nuk kemi mundur t'u japim zgjidhje të plotë. Disa nga to janë: Incidentet dhe zënkat ndërmjet nxënësve; lokalet afër shkollave; qentë endacak; komunikacioni, DKA në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për ruajtjen e rendit dhe sigurisë (drejtorinë e shkollave, organet e shkollave, policinë, QPS, OJQ etj.), do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mjedis të qetë dhe të sigurt në të gjitha institucionet edukative-arsimore.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, falënderojmë Drejtorin për informatën e paraqitur, e hap diskutimin lidhur me këtë pikë.

**z. Qefser Behrami,** theksoi, viti shkollor ka filluar mbarë, procesi mësimor është duke u zhvilluar mirë, me përjashtim të disa lekturave që ende nuk kanë arritur. Vlen të theksohet se ka filluar renovimi i shkollës së vjetër në Kërpimeh, duke iu falënderuar Kryetarit dhe stafit të tij dhe për këtë i tërë komuniteti i asaj pjese i gëzohet kësaj pune nga ana e autoriteteve komunale. Rrethoja e shkollës është, kamerat gjithashtu donacion nga OSBE. Si çështje shumë e nevojshme ka mbetur salla e edukatës fizike e cila sipas informacioneve ka hyrë në proces të realizimit.

**z. Bashkim Bajrami,** theksoi, do të potencojë një sfidë që është duke na krijuar probleme në trafik, fjala është te SHFMU " Ibrahim Rugova" ku prindërit të cilët i sjellin dhe i marrin fëmijët nga shkolla janë duke shkaktuar jashtëzakonisht tollovi të madhe. Nëse ka mundësi përmes drejtorëve të shkollave me biseduar me prindër me qëllim për të gjetur mënyrë tjetër jo të vijnë me vetura. Në këtë rast ne po jemi të detyruar të shqiptojmë tiketa. Pra me gjetur mënyrën e jo të vijnë me vetura, e të shkaktojnë tollovi në trafik.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, ne kemi vërejtur këtë dukuri të theksuar nga parafolësi dhe nuk jam në dijeni se si është gjendja te shkollat tjera por SHFMU " Ibrahim Rugova" dhe SHFMU " Shaban Shala " janë dy prej shkollave që kanë telashe në këtë aspekt, por mendoj që nuk e kanë të njëjtën problematikë sepse dallon gjendja problematike pran shkollës Ibrahim Rugova nga ajo e Shkollës Shaban Shala. Te shkolla " Ibrahim Rugova" janë disa biznese që po zhvillojnë aktivitete dhe qytetarët ushqehen dhe të gjitha makinat janë në trotuare gjë që u pamundësohet qytetarëve, në veçanti fëmijëve të lëvizin lirshëm. Mendoj se nuk mundemi tua ndalojmë prindërve të sjellin dhe marrin fëmijët nga shkolla, por do të kërkojmë nga të ndalojnë me këtë qasje në trotuar pran shkollës, por nëse ata prapë veprojnë në të njëjtën mënyrë mbetet që për këtë të veprojnë Policia, të ndërmarr masa. Mendoj që në kohën e qarkullimit më të madh aty dhe kur është koha e drekës që të ketë shtim të zyrtarëve policor për të monitoruar dhe për të qenë më afër këtyre dy objekteve shkollore. E dyta, nuk e pata në plan ta theksojë por dua ta them se trotuaret janë keq. Ndoshta mund të ketë resurse humane më të kufizuara dhe nuk jam në dijeni se si është situata por vërtetë qyteti është keq. U ndjeva shumë keq para pak ditësh kur një nënë me karrocë me bebe u detyrua ta lëshojë trotuarin për shkak të makinës në trotuar dhe doli në rrugë për të kaluar makinën dhe prapë u kthye në trotuar. Jam në dijeni se kulturën është problem tua japësh shpejtë, por edhe ata që shkelin rregullat mirë është të sanksionohen, por për t'u sanksionuar duhet të jetë afër zyrtari policor. Është e nevojshme që patrullimet në qytet të jenë më të shpeshta, në veçanti në rrugët që janë më të ngarkuara, sepse është bërë shumë shqetësuese zënia e trotuareve me makina. E di që nuk ka parkingje të mjaftueshme në Podujevë, kemi mungesë të tyre, por nuk është edhe që ka mungesë të parkingjeve, sepse janë një numër i madh i parkingjeve private që mund të shfrytëzohen. Janë parkingjet publike që i kemi bërë në kuadër të kapaciteteve dhe mundësive e të cilat ende janë pa pagesë. Jam në dijeni që keni shumë punë tjera të planifikuara e që dalin edhe të pa planifikuara por 2-3 ose 4 policë po të ishte mundësia do të ishte mirë që të angazhoheshin në qytet gjatë tërë ditës. Rruga që shpie në drejtim QKMF-së nga ora 4 e tutje është tejet e stërngarkuar për shkak të punës së ordinancave private, ku nganjëherë krijohet aq tollovi e madhe për shkak të bllokimit të trotuareve nga automjetet sa nuk ka mundësi për lëvizje të këmbësorëve në trotuare. Aty pranë ka edhe parking privat por për shkak të pagesës qytetarët nuk duan t'i shfrytëzojnë. Pra është mirë që te këto lokacione që u përmendën sipas mundësive të rritet angazhimi i zyrtarëve policor. Besoj se policia është duke u angazhuar, nuk po them maksimal, sepse e di që mund të bëhet më shumë, por shpresojmë që kjo të arrihet gradualisht.

**z. Bashkim Bajrami**, theksoi, z. Kryetar keni qenë aty kur kemi përgatitur planin operativ për qytet. Kritikën që i theksove qëndrojnë. Sa i përket angazhimit për qytet kam 4 zyrtar policor për mbulimin e të gjitha pikave por gjatë ditës po dalin punë dhe angazhime tjera kështu që detyrohemi t'i tërheqim. Dua të theksoj se numri i tiketave të shqiptuar nga Stacioni Policor i komunës vetëm për 3 muaj është 2943 e që është numër i madh për një komunë si e jona. Te shkolla " Ibrahim Rugova" nuk mendoj se prindi duhet të vijë çdo ditë dhe të ndalë automjetin në mes të rrugës apo të parkojë veturën në trotuar para rrethojës së shkollës ku janë duke krijuar tollovi të hatashme, ata duhet të vetëdijesohen në këtë aspekt. Pra deri te rrethi i Kërpimehut për qarkullim të automjeteve po bllokohet. Si rrjedhojë e kësaj gjendjeje po ka edhe aksidente dhe vetëm policët te shkolla nuk janë në gjendje të monitorojnë situatën 100%.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, ç'është e vërteta, ne po shohim se ka telashe, por as ne në parim nuk jemi për rritje numrit të tiketave sepse gjoha është masa e fundit që realisht duhet ndërmarrë, por nëse të themi personi NN vjen prej cilit do cep të Podujevës dhe parkon automjetin në mes të gjelbërimit aty duhet të pasoj gjoha. Me rritjen e numrit të gjobave nuk është se po ndjejmë kënaqësi, sinqerisht, sepse nuk i gëzohet askush dënimit dhe saksionit, por nëse nuk kemi zgjidhje tjetër, ose nëse ky ekip është pak më azhur se të tjerët më parë që realisht kanë kapërcyer dhe s'janë marrë me këto automjete prapë është një shenjë që është duke u punuar. Por ku është e mundshme qortimi nga ana e juaj është mirë të praktikohet si masë, por nëse janë aq shkelje të rënda që duhet sanksionuar, edhe pse theksova se ne nuk jemi për sanksione, faktikisht krijohet detyrim për ta ndërmarrë për shkak të papërgjegjësisë tonë qytetare që nganjëherë po ndodhin. Unë nganjëherë e shoh vet që shkojnë e parkohen në ven parkingun e caktuar për personat handicap dhe kur kemi shkelje kaq të rënda që masa e papërgjegjësisë shkon deri në atë masë detyrimisht duhet marr masa për ndaljen e kësaj dukurie. Mund të them se gjendja është shumë më mirë se që ka qenë, por pretendimet janë që të bëhet ende më mirë, sepse kërkesat e qytetarëve janë ende më mirë të bëhet. Dua të theksoj se bashkëpunimi nuk është duke munguar me institucionet relevante komunale dhe besoj se kemi vend ende për ngritje të nivelit. Nëse nuk ka dikush për të shtuar diçka rreth kësaj pike kalojmë në pikën e radhës.

#### **4. Informatë për shëndetësi**

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, fjalën e ka Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale znj. Adelinë Stublla.

**znj. Adelinë Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**, theksoi, sa i përket informatës për shëndetësi vlen të theksohet se kemi QKMF e cila përfshinë 4 qendra tjera të mjekësisë familjare dhe 18 ambulanta, si dhe urgjencën ku trajtohen rastet e shumta, përfshirë edhe ato të rënda. Brenda mjekësisë familjare përveç shërbimeve të tjera bëhen edhe shërbime të paliativitetit (Shërbime shëndetësore në shtëpi) shërbim për të cilin qytetarët janë shumë të kënaqur. Gjithashtu ofrohen shërbimet edhe për nënat shtatzëna, për fëmijët 0-3 vjet, ku falë këtyre shërbimeve po zbulohen sëmundje të ndryshme te fëmijët. Ndër shërbime tjera në kuadër të mjekësisë familjare kryhen edhe shërbime radiologjike, mamografi, ultrazë, pediatri, gjinekologji, epidemiologji, vaksinim, infuzione, EKG, farmaci, lidhtore, ndërhyrje stomatologjike dhe shërbime laboratorike. Në QPS kryhen shumë aktivitete por për shkak të natyrës konfidenciale të rasteve puna e tyre nuk promovohet. Për herë të parë kemi siguruar edhe praninë e zyrtarëve policor për sigurinë e personelit dhe qytetarëve gjatë takimeve që ndodhin në fazën pas divorcit. Në këtë objekt është bërë edhe instalimi i kamerave të sigurisë. Në lidhje me mirëqenie sociale jemi në proces të ndërtimit të 3 shtëpive në bashkëpunim me Shoqatën " Jetimat e Ballkanit" përfaqësuar nga z.Halil Kastrati dhe Komunën. Dy familje të tjera janë në pritje të fillimit të ndërtimit të shtëpive. Ne i ndihmojmë vazhdimisht qytetarët me pako ushqimore. Ndër projektet që duhet përmendur është Urgjenca e re e cila është në fazën përfundimtare dhe do të ofrojë kushte moderne dhe siguri të lartë duke përfshirë praninë e dy zyrtarëve policorë, që do të jetë me orar të plotë 24 orë. Projekt tjetër është ndërtimi i Qendrës

Rezidenciale për persona të moshuar e cila është e shumë pritur nga qytetarët. Dua të ju njoftoj se furnizimi me aparatura dhe barna është i kënaqshëm si në qendër ashtu edhe në terren. Falë marrëveshjes me Policinë siguria është në nivel për personelin shëndetësorë.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, e hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**z. Shefki Selmani,** theksoi, kam një pyetje për Drejtoreshën lidhur me shërbimin paliativ, shërbimi i cekur a ofrohet çdo ditë të javës apo vetëm 5 ditë në javë.

**znj. Adelinë Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,** theksoi, shërbimi paliativ ofrohet çdo ditë të javës, pra duke përfshirë edhe ditëve të vikendit dhe atë deri në ora 23:00.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, nëse nuk ka dikush diçka tjetër për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

## **5. Masat parandaluese dhe sensibilizimi i qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrje-shirjeve dhe djegieve të pyjeve, dhe vërshimeve (koordinimi i aktiviteteve në mes DBPZHR, DSHPMSh, SZSH, Policisë, Agjencionin Pyjor, Agjencionin e Menaxhimit Emergjent**

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, fjalën ia kalojmë z. Bahri Selimit.

**z. Bahri Selimi,** theksoi, sa i përket kësaj pike dua të ju njoftoj se ne kemi koordinim të vazhdueshëm me gjithë dikasteret të cilët kanë të bëjnë me këtë çështje dhe jemi të vetëdijshëm se situata me zjarre në Komunën e Podujevës është e pakënaqshme, sepse kohën e fundit ka zjarre të shumta, zjarre të hapura në barishte të thara, pyjet, ndërsa në ekonomitë familjare dhe objektet ndërtimore ka qenë numër më i vogël i zjarreve. Në bazë të raportit të cilin e pranojmë çdo muaj nga shërbimi i zjarrfikësve rezulton që vetëm në muajin gusht në sipërfaqe malore janë bërë 26 intervenime nga Njësia e Zjarrfikësve, ndërsa janë djegur 10.5 ha. Në barishte gjatë muajit gusht ka pas 80 intervenime, ndërsa sipërfaqe të djegura janë 188 ha. Në sipërfaqe bujqësore ka pas 5 intervenime me sipërfaqe të djegura prej 4.5 ha. Do të thotë vetëm në zjarre të hapura në këto 3 kategori gjithsejtë kemi pas 117 intervenime gjatë muajit gusht, çka nënkupton se numri i intervenimeve është shumë i madh, e aq më tepër duke krahasuar me numrin e vogël të zjarrfikësve që kemi në komunën tonë. Sa i përket masave sensibilizuese me qytetarë mund të them se në çdo fillim vit gjatë sezonit veror kur ka djegie më të mëdha të pyjeve dhe fushave ne i bëjmë thirrje përmes rrjeteve sociale dhe mediave që qytetarët të jenë të kujdesshëm në këtë aspekt, por është vërtetuar se kjo shumë pak ka pas ndikim. Sa i përket vërshimeve fatmirësisht në fund vitin e fundit dhe këtë vit ende nuk kemi një situatë alarmante ku duhej intervenuar. Ne si Drejtori e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit kemi lidhur kontratë për mirëmbajtjen e lumenjve dhe jemi duke intervenuar në ato pika ku ne i kemi të identifikuar si pika të rrezikshme, ku zakonisht me rritjen e nivelit të ujit ka dalje të ujit nga shtretërit e lumenjve dhe ne jemi duke bërë hapje në ato pika. Gjithashtu dua të ju njoftoj se kemi lidhur një kontratë të re për ujëra atmosferike, ku kemi pas raste edhe të rrezikimit të shtëpive si pasojë e vërshimeve, me ç'rast kemi hap edhe disa kanale të reja atmosferike. Po ashtu jemi edhe në përgatitje të një kontrate tjetër për rregullimin e shtratit të lumenjve e cila tashmë është në procedurë të projektimit, pra jemi në pritje të lidhjes së kësaj kontrate, në mënyrë që të bëjmë një projektim të të gjithë lumenjve në territorin e Komunës së Podujevës dhe pastaj të fillojmë me rregullimin dhe ndërtimin e shtretërve të lumenjve. Kjo është ajo çka ne kemi bërë si Drejtori, por edhe si Njësi e Shërbimit të Zjarrfikësve për parandalimin e këtyre dukurive të rrezikshme që janë në Komunën tonë.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, e hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës, nëse ka dikush diçka për të shtuar apo ndonjë sugjerim. Meqë nuk ka të interesuar e përmbyllim këtë pikë.



## **6. Të ndryshme**

Nuk pat diskutime

Kryetari e mbylli takimin, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:10**

**Procesverbalin e mbajti**

**Sabedin Namani**

**Nr. prot. 02-060/04-0065506/24**

**Podujevë, datë: 30.09. 2024**



**Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi**